# KICER 2025

EDICIONI 5

## KONFERENCA NDËRKOMBËTARE E KOSOVËS PËR HULUMTIMET NË ARSIM

## ARSIMI NË NJË EPOKË TË GLOBALIZUAR: SFIDAT DHE MUNDËSITË PËR MËSIMDHËNIE DHE MËSIMNXËNIE TRANSFORMUESE



### THIRRJE PËR ABSTRAKTE

Fakulteti i Edukimit në Universitetin e Prishtinës, përmes Institutit për Hulumtime dhe Zhvillim të Arsimit (IHZHA), ftojnë të gjithë edukatorët, mësimdhënësit dhe profesionistët tjerë të arsimit për të aplikuar me abstrakte në Konferencën e 5të të Kosovës për Hulumtimet në Arsim- KICER 2025

### QËLLIMI I KONFERENCËS

Këtë vit, KICER ka fokus kryesor **Arsimin në një Epokë të Globalizuar**, duke u përqendruar në mënyrën se si sistemet arsimore evoluojnë për të përmbushur kërkesat dhe për të shfrytëzuar mundësitë që ofron një botë gjithnjë e më komplekse dhe e ndërlidhur. Në këtë kontekst, konferenca synon të shqyrtojë ndikimin e globalizimit në arsimin modern, duke eksploruar sfidat dhe mundësitë që lidhen me zhvillimin e politikave, praktikave dhe qasjeve të reja arsimore.



### DATA TË RËNDËSISHME

| | |
|---|---|
| Afati për dorëzim të abstrakteve: | 15 Mars |
| Njoftimi për pranim të abstrakteve | 10 Prill |
| Afati për regjistrim për pjesëmarrje: | 15 Qershor |
| Datat e konferencës | 26–27 Qershor |

### TEMATIKAT E KONFERENCËS

**Motivimi i mësimdhënësve krahas mungesës globale të mësimdhënësve-** identifikimi dhe zbatimi i strategjive të qëndrueshme për të frymëzuar dhe mbështetur mësimdhënësit, veçanërisht në kohën kur mungesa e mësuesve është bërë një sfidë globale.

**Integrimi global dhe përgatitja e mësimdhënësve: praktikat për të ardhmen-** si programet e përgatitjes së mësimdhënësve mund të adresojnë nevojat e një bote gjithnjë e më të globalizuar, duke nxitur krijimin e një fuqie punëtore arsimore të aftë për t'u përshtatur në mjedise të larmishme.

**Skenarë për zhvillimin e praktikave shkollore në kontekste komplekse-** vizione dhe skenarë të bazuar në praktika që mund të ndihmojnë shkollat të përballen me kontekste të ndryshme dhe të paparashikuara.

**Praktika inovative në klasa për kompetencat globale dhe të nxënit holistik-** risitë në metodologjitë mësimore që mbështesin zhvillimin e kompetencave globale dhe qasjen gjithëpërfshirëse ndaj nxënies, duke theksuar edukimin e bazuar në vlera, integrimin e TIK-ut dhe metodat ndërdisiplinore të mësimdhënies.

5TH KOSOVA INTERNATIONAL CONFERENCE ON EDUCATIONAL RESEARCH

# KICER 2025

EDICIONI 5

## KONFERENCA NDËRKOMBËTARE PËR HULUMTIMET NË ARSIM

### ARSIMI NË NJË EPOKË TË GLOBALIZUAR: SFIDAT DHE MUNDËSITË PËR MËSIMDHËNIE DHE MËSIMNXËNIE TRANSFORMUESE

## UDHËZIME PËR ABSTRAKTE

- Një abstrakt është një përmbledhje e punimit tuaj kërkimor që përmban titullin dhe një hyrje të shkurtër mbi temën, qëllimin, metodologjinë kërkimore, gjetjet/implikimet kryesore (të pritshme) dhe përfundimet
- Abstrakti nuk duhet të kalojë 350 fjalë dhe tri/katër fjalë kyçe
- Tema e abstraktit duhet të lidhet me njërën nga fushat tematike të përcaktuara (të sesioneve paralele ose sesioneve me poster prezentime)
- Abstrakti mund të dorëzohet në gjuhën shqipe apo në gjuhën angleze
- Abstrakti i dorëzuar duhet të jetë anonim brenda dokumentit
- Abstrakti duhet të dërgohet brenda afatit të përcaktuar në email adresën: konferenca.edukim@uni-pr.edu dhe me titullin "Abstrakt për prezentim në sesion paralel" apo "Abstrakt për prezentim në sesionin me poster prezentime"

## BORDI SHKENCOR I KONFERENCËS

Prof. Ass. Blerta Perolli Shehu
Prof. Dr. Naser Zabeli
Prof. Dr. Eda Vula
Prof. Asoc. Kastriot Buza
Prof. Asoc. Zeqir Veselaj
Prof. Asoc. Teuta Danuza
Prof. Asoc. Arlinda Beka
Prof. Ass. Albulena Metaj
Prof. Ass. Veli Kryeziu
Dr. sc. Elmedina Kurti

## BORDI ORGANIZATIV I KONFERENCËS

Prof. Ass. Rozafa Ferizi Shala
Prof. Asoc. Kyvete Shatri
Prof. Ass. Iliriana Tahiraj
Prof. Ass. Donika Koliqi
PhDC. Arian Musliu
PhDC. Jete Aliu
PhDC. Vlera Jashari
PhDC. Faton Mazreku
PhDC. Blerina Tafolli

## FORMATI I KONFERENCËS

Ngjarja para konferencës:
FEduTalk *"E ardhmja e përgatitjes së mësimdhënësve në Kosovë"* (25 Qershor)

Ngjarjet gjatë konferencës:
4 fjalime kyçe
12 sesione për prezentim të punimeve shkencore
Sesioni me prezentime poster që ndërlidhen me tematikat e konferencës
2 punëtori praktike me edukatorë dhe mësimdhënës

KICER është konferencë hibride, që organizohet me prezencë fizike për pjesëmarrësit vendor, dhe me prezencë online për pjesëmarrësit jashtë vendit.

Konferenca është pa pagesë!

Konferenca mbahet në gjuhën shqipe dhe gjuhën angleze (me përkthim simultan)

Kontakt: konferenca.edukim@uni-pr.edu
www.edukimi.uni-pr.edu

**BËHU PJESË E KONFERENCËS MË TË MADHE ARSIMORE NË VEND!**